



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar 10/01 2023			
Nj. Org.	Numër	Shitja	Vlera
02-	052/01	1966	

Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit



**Kuvendi
Komiteti për Komunitete**

PROPOZIM

Raporti për vitin 2022

Hyrje

Komiteti për Komunitete, në vitin 2022, punët dhe aktivitetet i ka fokusuar në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi mbi bazën e dispozitave ligjore, punëve dhe aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës.

Puna dhe aktivitetet

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 6 mbledhje të rregullta, dhe janë shqyrtuar disa çështje. Në fillim të muajit Shkurt 2022 është zgjedhur Kryesuesi i këtij Komiteti si dhe është miratuar Plan i Punës për vitin 2022.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Prill, për punën dhe aktivitetet ka raportuar përfaqësuesja e Zyres për Komunitete dhe Kthim znj. Afije Veseli.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Maj, lidhur me temën "Diskutim për qent endacak" e ftuar ka qenë Drejtoresha e Shërbimeve Publike znj. Lumnije Krapit, e cila ka folur për punën e Komunës së Drenasit për trajtimin e qenve endacak.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Korrik, për temën "Raportim nga Handikos" i ftuar ka qenë përfaqësuesi i Handikos në Drenas z. Bexhet Binaku, i cili ka folur për punën e kësaj organizate në komunën e Drenasit.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Shtator, temë diskutimi ishte "Tetori-Muaji ndërkombëtar i kancerit të gjirit", për të diskutuar për këtë temë i ftuar ishte Drejtori i Shendetësisë në komunën e Drenasit z.Arsim Haxhiu.

Në mbledhjen e fundit që u mbajt në muajin Dhjetor, temë diskutimi ishte "Raportim nga Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave", për punën dhe aktivitetet e kësaj qendre foli znj.Eronita Brahimi.

Drenas, Janar 2023

Kryesuesi i Komitetit



Drin Halilaj